



KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0005630-10/26, dt. 10.02.2026

Mitrovicë

02-060/01-0005630-10/26
10.02.2026

Në zbatim të nenit 12, paragrafi 2, alineja d, dhe nenit 51, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); neneve 13 paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 dhe 61, paragrafi 2, të Statutit të Komunës; nenit 13, paragrafët: 1 dhe 3, si dhe nenit 14, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në komunë dhe komiteteve tjera; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më dt. 10.02.2026, sjell këtë:

VENDIM

Për formimin e Komitetit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim

1. Miratohet Vendimi për formimin e Komitetit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.
2. Komiteti i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, është në këtë përbërje:
 - 2.1 Egzon Hamza
 - 2.2 Oltion Ahmeti,
 - 2.3 Xhevdet Osmani,
 - 2.4 Mihrije Rexha Ilaziri, dhe
 - 2.5 Adclina Brahimi.
3. Kompetencat dhe aktivitetet e komitetit janë të përcaktuara me Rregulloren Komunale Nr. 01/2009 Për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës, si në vijim:
 - 3.1 Të këshillohet dhe konsultohet me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Infrastrukturës dhe Drejtorinë e Mbrojtjes dhe Shpëtimit;
 - 3.2 Diskutojnë, ndryshojnë projekt-rregulloret e përgatitura nga drejtoritë dhe i dorëzojnë Komitetit për Politikë dhe Financa;
 - 3.3 Përmes bordeve të ndërmarrjeve komunale: themelon vijë veprime, përshtatë nivelet e shërbimeve dhe stafit, monitoron dhe vlerëson efikasitetin e metodave dhe procedurave në afirimin e shërbimeve;
 - 3.4 Të propozojë masat adekuate dhe të angazhojë institucionet përkatëse për ndihmë popullsisë së rrezikuar me qëllim të zbutjes së dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë elementare (tërmetet, vërshimet, zjarri etj);
 - 3.5 Të marrë masa adekuate për angazhimin e potencialit njerëzor dhe mjeteve materiale në zvogëlimin dhe eliminimin sa më të mundshëm të pasojave të shkaktuara nga këto fatkeqësi, duke vepruar konkretisht në vendin e ngjarjes;
 - 3.6 Të propozojë masa konkrete për funksionimin e Qendrës për koordinim, informim dhe alarmim;
 - 3.7 Të koordinojë punët me Njësitin e zjarri-fiksues për reagim sa më të shpejtë në rast të paraqitjes së nevojës;
 - 3.8 Të koordinojë punët me Policinë e Kosovës, FSK-në, Shtëpinë e Shëndetit dhe Kryqin e Kuq Komunal, për një organizim më efikas në zbutjen e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë e ndryshme.
4. Zgjedhja e kryesuesit të komitetit bëhet me shumicën e votave të anëtarëve të komitetit. Në rast të mungesës së kryesuesit, mbledhjen e kryeson anëtari më i vjetër i komitetit.
5. Komiteti i dorëzon Kuvendit të Komunës raportin vjetor të punës së tyre për shqyrtim dhe miratim.
6. Mandati i anëtarëve të Komitetit për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim është i lidhur me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës.
7. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Dorëzohet: 1 x 1 Kryesuesit të Kuvendit
1 x 1 MAPL-së
1 x 1 Arkivit
Kopje: Kryetarit të Komunës
Anëtarëve të komitetit



Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI